

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PR OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërtim i Godines se Re Backup per QKUM Vlorë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT : Punë ndërtimi 45000000-7

FONDI LIMIT: 120,006,896.11 *(njqind e njezet milion e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH*

KOHEZGJATJA E KONTRATES/MARREVESHJES KUADER OSE AFATI PER ZBATIMIN E SAJ : 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarikë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike ,Relacione , Projektet , Preventivi etj. dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoriteti Kontraktor përfituesi cili kërkon realizimin e punimeve.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar); si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklarimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të balanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (**2022, 2023, 2024**) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në

atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël***”.

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo me te vogël se **50%** e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **60,003,448** (gjashtëdhjetë milion e tre mijë e katërqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **240,013,792** (dyqind e dyzet milion e trembëdhjetë mijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

Plotesimi i njerit prej dy kushteve të siperpermendura të bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 1/a plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1. Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i përfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Certifikatën e marrjes në dorezim/Certifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.

Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
- Kontratë Sipërmarrje
 - Situacionin përfundimtar;
 - Fatura tatimore perkatese të deklaruara në organet tatimore.
 - Aktin e kolaudimit;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.

Shënim : *Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, dhe faktin nëse kontrata është realizuar me sukses.*

- 1.1** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.2** Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor; si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e ulët monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.

Për punimet e përgjithshme në ndërtim :

- **NP-1 A** Punime germimi ne toke
- **NP- 2 D** Ndërtime civile dhe industrial
- **NP –12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.

Për punimet speciale të ndërtimit :

- **NS-2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
- **NS-3 A** Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse , transportues)
- **NS-4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
- **NS-12 A** Impiante teknologjike ,termike dhe te kondicionimit
- **NS-14 B** Impiante te brendshme elektrike,telefonike,radiotelefoni TV

- **NS-18 A Punime Topogjeodezike**

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve.

-Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP 1 A	Punime gërmimi ne toke	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne themele gjeresi, toke zak, kategoria III, me shkarkim ne toke Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 10.0 km Hedhje,rrafshim,mbushje dheu me krah, kategoria III	A (0- 20 milionë lekë)
NP-2D	Ndertimie civile dhe industriale	F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm F V konstruksione metalike te thjeshta F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm Shtrese betoni C 16/20 Arkitrare b/a C 25/30, h~4 m Struktura monolite betoni me çakell C 30/37 etj	D (101- 200 milionë lekë)
NP-12A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	Punimet per ndertimin e objektit kane impakt mjedisor ne te gjithë zonen perreth saj duke pasur parasysh pozicionimin e saj ne zone e banuar urbane , sasine e e mbetjeve te gjeneruara nga punimet e germimeve , për menaxhimin e punime të ujrave të ndotura etj duke ju permbajtur VNM .	A (0- 20 milionë lekë)
NS-2A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	F.V lavaman porcelani F.V bide porcelan F.V bolier 100 l F.V pilete dysHEMEJE Ø 50 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16 FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, Pn 16 F V bolier 12 liter, uje te ngrohete sanitar F V bolier 80 liter, uje te ngrohete Tub PEX/al, (Ø16 x 2.0) mm dhe rakorderi, i	A (0-20 milionë lekë)

		termoizoluar $\delta=6\text{mm}$ Tub PEX/al, ($\varnothing 20 \times 3$) mm, dhe rakorderi i termoizoluar $\delta=6\text{mm}$ Kolektor për shpërndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4" me (5+4) dalje $\times 1/2"$ I kompletuar me të gjithë aksesoret buketonë, saracineska këndore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2" Kolektor për shpërndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4" me (7+5) dalje $\times 1/2"$ I kompletuar me të gjithë aksesoret buketonë, saracineska këndore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2" Kolektor për shpërndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4" me (8+6) dalje $\times 1/2"$ I kompletuar me të gjithë aksesoret buketonë, saracineska këndore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2" Kolektor për shpërndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4" me (6) dalje $\times 1/2"$ I kompletuar me të gjithë aksesoret buketonë, saracineska këndore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2" Kolektor për shpërndarjen e Ujit Sanitar me Hyrje, 3/4" me (7) dalje $\times 1/2"$ I kompletuar me të gjithë aksesoret buketonë, saracineska këndore me hollandez, tapa bronzi fundore 3/4" dhe kasetë kolektori dhe tapa prove 1/2" WC incasso Pllake dushi Komplet tualeti WC, Lavaman, si aksesor per instalimin e ne mure per personat me aftesi te kufizuar Rakorderi celik zingato per furnizimin e depos me uje 1 1/2" (kundravalvola, saracineska, galexhant elektrik, galexhant mekanik, niple, reduktor presioni) Tuba dhe rakorderi shkarkimi PP $\varnothing 50\text{ mm}$ Tuba dhe rakorderi shkarkimi PP $\varnothing 75\text{ mm}$ Tuba dhe rakorderi shkarkimi PP $\varnothing 110\text{ mm}$ Tuba HDPE i brinjëzuar $\varnothing 110\text{ mm}$ Tapa inspektimi PP $\varnothing 110\text{mm}$ Sifon PP $\varnothing 110\text{mm}$ Fasheta per tub PP $\varnothing 110$ me guanicion gome dhe element fiksimi në suport Pusete shkarkimi b/a 60x60 cm, h=100 cm Valvol ajri poshte lavamanit DN 50 Tuba dhe rakorderi shkarkimi per ujrart e shiut PP $\varnothing 75\text{ mm}$ Tuba HDPE I brinjëzuar $\varnothing 110\text{ mm}$ Tuba HDPE I brinjëzuar $\varnothing 125\text{ mm}$ Tuba HDPE I brinjëzuar $\varnothing 160\text{ mm}$ Tapa inspektimi PP $\varnothing 75\text{mm}$ Pileta horizontale tarrace $\varnothing 75$ Fasheta per tub PP $\varnothing 75$ me guanicion gome dhe element fiksimi në suport Pusete b/a shiu 60x60 cm, h=100 cm V.Pompe drenazhi 10m³/h, H=10m V Ene zgjerimi e pompes se ujit Karakteristikat Teknike: - Presioni min/max : 3/10 bar, -Kapaciteti 300 lit-De = 634 mm-H = 1267 mm Lidhjet: F $\varnothing 1 1/4"$-Bashke me rakorderite e lidhjes V. Pompa e furnizimit me uje Karakteristikat Teknike: - Prurja: 9.8m³/h;-Prevalenca: 45 mkH₂O;-Tensioni i dhenë : 3F - 400V / 50 Hz; -Bashke me rakorderite per lidhjen Tub HDPE $\varnothing 63\text{mm}$ Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 150 cm Fikëse zjarri Tabela detektimi Sinjalizimi
--	--	---

		Buton sinjalizimi i zjarrit Zbritje shkalle Drejt看 i daljes së emergjences Tabele Per ndalim cigare Tabele mos perdorimi i ujit ne zjarr Tabele paisje elektrike Tubo çeliku i zi (Ø3" x 3.25 mm, me mberthime) F.V Tubo çeliku i zi (Ø 2½" x 3.25 mm, me mberthime) F.V Tubo çeliku i zi (Ø 2" x 3.25 mm, me mberthime) F.V Tubo çeliku i zi (Ø 1½" x 2.90 mm, me mberthime) F.V Tubo çeliku i zi (Ø 1 1/4 x 2.20 mm, me mberthime) F.V Tubo çeliku i zi (Ø 1 x 2.20 mm, me mberthime) F.V Rakorderi çeliku i zi (Bryla,Ti, reduksione etj). V. Kaset + hidrant zjarri i brendshëm. Kasetë brenda murit, llamarine çeliku e emaluar me ngjyrë të kuqe RAL 3000 - UNI 9227, V. Grupi i lidhjes me motopompen për hidrant DN 65. Vendosi në kasetë të jashtme, llamarine çeliku të emaluar ne ngjyre, te kuqe RAL 3000, valvol sigurie dhe moskthimi 2" (DN 50) materiali i grupit bronz. V. MONTIMI I POMPES SE ZJARRIT BASHKE ME AKSESORET E MKZ: Pompe furnizimi per sistemin e mbrojtjes nga zjarri e kompozuar referuar normes EN 12845 V. Fikëse zjarr me pluhur, destinacioni per mbrojtjen e paisjeve elektrike ne ndertes. Tip bombel (e levizshem). Klasa e zjarrit 55A 233BC, kapaciteti normal 12 kg, pesha 17.6 kg. Diametri 190mm, lartesia 640 mm. etj	
NS-3A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	Ashensor i kompletuar me te gjitha aksesoret per mallra dhe pasagjer sipas standartit EN 81-1 Kapaciteti: 6 persona, Shpejtesia:1m/s me 2 Ndalesa, 2 Porta	A (0-20 milionë lekë)
NS-4B	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	Skele me tubo fasade ~ 8m Boje hidroplastike cilesi e larte Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm Mur tulle me vrima, t=20cm Mur me tulla me 8 vrima, t=10cm h~3m, ll perz M 15 Ndetim muri me gips t=10cm me dy shtresa Shtresë avull izoluese me barrier alumini Shtrese me pllaka porcelanat Shtrese betoni C16/20 me zgare hekuri Shtrese me pllaka grez importi, 40x40cm Shkalle montazhi mermeri Shtrese me pllaka mermeri t=2cm Shtrese me pllaka graniti t=2cm Shtrese parketi Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt Shtrese avullizoluese gjeotekstil Shtrese parketi laminat Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama Veshje kornize llamarine xingat Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva. Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm Veshje tavani me kartonxhes Patinim tavani allçi (stuko) Plintuse grez h = 10 cm Plintuse mermeri h = 10cm V F dyer te brendeshme tamburate te rimesuara Dyer te blinduara Vendosje dyer te blinduara F V dritare d/alumini plastike me dopio xham F V vetrare d/alumini plastike me dopio xham Shirita metalike+gome per fuga temperature solete FV Mbushje me beton te lehtesuar Shtrim dysHEME te mbingritur	B (21-50 milionë lekë)

		F.v Linoleum Tavan i varur me kartonxhes F.V Perde te brendshme rul F.V Vetrate strukturale F.V Mekanizem dere xhami rreshkitese dopio Llamarine e perforuar per hijezim jashte etj	
NS-12A	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	Tubo bakri Ø 6.35mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 9.53mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 12.7mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 15.9 mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 19.1 mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 22.2 mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 28.6 mm per gas Frigoriferik R410A Tubo bakri Ø 234.9 mm per gas Frigoriferik R410A Brrage Kabull elektrik te skremuar FROR 3x1.5 mm2 (sistemi BUS) F.V Mbushja e sistemit me gas ftohes R410A F.V Azot (bombul) 60 Lit Kompleti i tubacioneve me shumë lidhje të njësisë së jashtme për 2 module, Kontrolluesi inteligjent me prekje - lejon monitorimin dhe funksionimin e detajuar dhe të lehtë të sistemeve VRV, Paneli i ri dekorativ (i bardhë), Paneli standard i dekorimit, F.V Tub PP me gote per largimin e kondensatit, bashke me atresacure per bashkimin dhe rakorderite perkatese Ø 32 mm F.V Tub PP me gote per largimin e kondensatit, bashke me atresacure per bashkimin dhe rakorderite perkatese Ø 40 mm F.V Tub PP me gote per largimin e kondensatit, bashke me atresacure per bashkimin dhe rakorderite perkatese Ø 50 mm F.V Fasheta per mberthimin e tubave vertikale dhe kondesati Elemente montimi dhe mberthimi. (upa, fasheta, prizhioner, profile metalike, stafa, bulloneri, Upa metalike betoni, Gur fresibel Armaflex per Tubo bakri 13mmØ 22.2 mm Armaflex per Tubo bakri 13mmØ 28.6 mm Elektroda saldimi bronxi - lidhje argjendi L Ag4 Paste deoksiduese per saldim (kuti - 250 gr) Kolektor shperndares VRF per kapacitet ftohes / ngrohes me kater tete dalje 45-65 kW, Lidhje kryesore Ø 28.6mm/ Ø 22.2mm , V KOMPRESOR I SISTEMIT "VRV" VERSION POMPE NXEHTESIE - (Ngrohje jo e vazhdueshme VRV IV), - Kapaciteti termik maksimal ne Ftohje: Q = 45 kW - Kapaciteti termik maksimal ne Ngrohje: Q = 50 kW - SCOP = 4.0 -SEER=6.0 V.Pajisje e Kondicionimi - Njësi e hollë me tavan të fshehur, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2 / 2.5 kW, prurja e ajrit mesatare =480 m³/h, fuqia elektrike 26W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.7mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithethelemente V.Pajisje e Kondicionimi - Round Flow: Kasetë me rrjedhje të rrumbullakët, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 3.6 / 4.0kW, prurja e ajrit mesatare =768m³/h, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.7mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithethelemente e nevojshem V.Pajisje e brendshme VRV Tipi Kasete me kater drejtime, Round Flow: Kasetë me rrjedhje të rrumbullakët, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 9.0/ 10.0 kW,, prurja e ajrit mesatare =1380m³/h, fuqia elektrike 36W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 15.9 mm / Ø9.5 mm, Ventilator DC Inverter	A (0-20 milionë lekë)

		V.Pajisje e brendshme VRV - Kasetë plotësisht e sheshtë , kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1.7/ 1.9 kW, prurja e ajrit mesatare =480 m³/h, fuqia elektrike 40 W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 9.5 mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithë elemente V.Pajisje e brendshme VRVKasetë plotësisht e sheshtë, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2/2.5 kW, prurja e ajrit mesatare =480 m³/h, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.75 mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithë elemente e nevojshem per montim Kanale ajri prej paneli poliuretani I veshur me shtrese alumini nga te dyja anet per aplikime ne ambiente te brendshme, spesori 20.5 mm, desiteti 52 kg / m3, trashesia e aluminit , 80/80 micron, Tubacione fleksibel - (combi flex) Ø 102 Tubacione fleksibel - (combi flex) Ø 127 Tubacione fleksibel - (combi flex) Ø 202 Tubacione fleksibel - (combi flex) Ø 252 Qafa llamarine Ø 100 Qafa llamarine Ø 125 Qafa llamarine Ø 150 Qafa llamarine Ø 250 Damfer manual per kontrollin e sasise se ajrit me lve , ku shenohet sasia e ajrit, $\Delta p_{st} = 50$ Pa, nivel zhurme 16 dB (A), Prurje ajri ne ttargetet : 14 - 82 m³/h, Ø 102 mm , Damfer manual per kontrollin e sasise se ajrit me lve , ku shenohet sasia e ajrit, $\Delta p_{st} = 50$ Pa, nivel zhurme 16 dB (A), Prurje ajri ne ttargetet : 50 - 265 m³/h, Ø 151 mm SLOT 150X8 Grile me 2 rreshta per marrje ajri prej alumini e anodizuar me permasa 425x125 mm, bashke me damferin drejtkendror per ballanin e ajrit per sasi ajri Q = 100~ 200 m³/h Grile me 2 rreshta per dhenie ajri prej alumini e anodizuar me permasa 425x125 mm, per sasi ajri Q = 100~ 200 m³/h Grile me 2 rreshta per dhenie ajri prej alumini e anodizuar me permasa 650x 200 mm, per sasi ajri Q = 100~ 600 m³/h (SALLA) Grile me 1 rreshta per marrje ajri prej alumini e anodizuar me permasa 650x 200 mm, per sasi ajri Q = 100~ 600 m³/h (SALLA) Grile Shiu prej alumini e anodizuar me permasa 1400x200 mm, per sasi ajri Q = 780 m³/h Grile Shiu per shkarkim ajri me 45° , 400x200 mm Grile Shiu per shkarkim ajri me 45° , 800x200 mm etj	
NS-14B	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.	F.V tub plastmasi Ø 11-13mm F.V tub plastmasi Ø 18-21mm F.V tub plastmasi Ø 27-30mm F.V percjelles PV-500 Ø 1.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 2.5 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 4 mm2 F.V percjelles PV-500 Ø 6 mm2 F.V Çelesa e priza 10 A me nulifikim F.V Kutiderivacioni plastm F.V priza shuko universal F.V kuti suport pllaket 4 mod F.V kuti suport pllaket 2 mod F.V. Kanaline metalike 210x65 F.V. Panel I matjes se energjise 1/3 fazor, 10 poste F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m F.V. Percjelles Tokezimi , Cu, S=35mm2, i zhveshur F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm F.V. Ndricues tip plafoniere, emergjence, 1x18w, IP65 F. V. Kuader elektrik kryesor kati 0 (KEK), sipas skemes pershkruar ne projekt me automat kryesor 300A	B (21-50 milionë lekë)

		, komplet F. V. Kuader elektrik kati 1 (KE 0, KE +1, K SERVERA, K MNZ), sipas skemes pershkruar ne projekt me automat kryesor 80A , komplet F.V. Kuader elektrik zyra me automat kryesor 20/25A, komplet F.V. Kuader elektrik TUALET, (KEWC) me automat kryesor 25A, komplet F. V. Kuader elektrik HVAC , me automat kryesor160A, komplet F.V. Kuader elektrik Pompat , (KEP, MNZ), me automat kryesor 40A, komplet F.V tub plastmasi Ø 60 mm F.V kabell FG70R 5*4mm² F.V kabell FG70R 5*6mm² F.V KABELL FG70R 4*120 +75mm² F.V kabell FG70R 5*25mm² F.V kabell FG70R 5*16mm² F.V. Sensor pozicioni 360°, 10A, 220V F.V. Minikolonë 2 Prize " Schucko " 25A+priza rrjeti F.V. Kanaline metalike (tip Ladder) 200x75mm (per kollonat) F.V. Kanaline PVC 20x20mm komplet me aksesore Aksesore per fiksimin e kablllove vertikalisht(morseta metalike me shtrenguese dhe mbrojtese kablli) Clamp clips me seksione te ndryshme F,V Shtizë rrufepritësi L-0.6-1m F.V. Morseta bashkuese T, L dhe +, universale F.V. Shkeputes per matje komplet+kuti PT5,IP65" Toke" F.V. puseta betoni 1*1*1m me kapak gize F.V. puseta plastike 0.3*0.3*0.3m me kapak te forte V Ndricues LED 26W IP65 V. Ndricues emergjence 1x18W IP65 me piktogram V. Ndricues LED 2* 40W IP67+shtyllë metalike h=4-5m V.Ndricues LED 33-36W IP40 (60*60cm) V.Ndricues LED linear 33-36W IP40 (180-200cm) V. Gjenerator diesel 3fazor 100KVA me panel komandimi komplet V.Pajisje UPS 3 kVA,220V me kohembajtje 10 min APC Sistem panel diellor per ngrohje uji , 300 litra, komplet Priza rrjeti kompjuterik tip RJ-45, cat 6e, FTP vendosur ne kuti 2 modulshe ne mur ose tavoline Priza rrjeti telefonik tip RJ-45, cat 6e, UTP vendosur ne kuti 2 modulshe ne mur ose tavoline Kabell rrjeti kompjuterik, Tip FTP-cat 6a; 1200MHz up 1500 MHz, 100 OHMS; AWG 23; LSOH, Flame retardant Kabllo per transmetim me cilesi dhe shpejtesi te larte HDMI komplet me konktore te parapergatitur, L= 25 m Kabllo per transmetim me cilesi dhe shpejtesi te larte VGA komplet me konktore te parapergatitur, L= 25 m Kabell zjarri me izolim PVC, ,S=2x2x0,8 mm², REI 120 Kabell zjarri me izolim PVC, - 59,S=2x1 mm², REI 120 Kabell BUS 2x2+2x0,8 mm². Kabell BUS 10x0,4 mm². Kabllo rrjeti kompjuterik, Tip UTP-cat6 LSZH, 250MHz up to 350 MHz Flame retardant Kabllo rrjeti kompjuterik, Tip FTP-cat6a LSZH, 350MHz up to 500 MHz Flame retardant Kabllo rrjeti, Tip outdoor CAT 6 Veshje muresh me pllake gipsi zjardurues Patinim muri gipsi + Lyerje muresh me boje Autonivelim i dyshemese + boje epoksiste Pedane metalike Dysheme h=45mm + Struktura + Grila (5 cope) Batiskop	
--	--	---	--

		Dere me material zjarrdurues me doreze mekanike te brendeshme+montim Kabllo FG16OM16 1x50mm2 - Linja e furnizimit Kapikorda 50mm2 Kabllo FG16OM16 1x35mm2 - Linja e furnizimit (Toka) Kapikorda 35mm2 Kabllo FG16OM16 5x25mm2 UPS Kapikorda 25mm2 Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm;K.Z. FG16OR16-0,6/1 kV ; S=5x10 mm2 Crac Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm;K.Z. FG16OR16-0,6/1 kV; S=5x2.5 mm2 Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm;K.Z. FG16OR16-0,6/1 kV; S=3x6 mm2 (Rack) Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm;K.Z. FG16OR16-0,6/1 kV; S=3x2.5 mm2 Kabell bakri me izolim dhe veshje PVCm;K.Z. FG16OR16-0,6/1 kV; S=3x1.5 mm2 Priza industriale 2P+T 32A Bazament per prizat industriale . Prize shuko 16A/230V per instalim ne kanaline plastike Prize RJ45 Cat 6 per instalim ne kanaline plastike Kanaline plastike per poste pune 75x55 ose ekuivalente Kend 90 grade ne plan per kanaline plastike 75x55 ose ekuivalente Frut çeles 1 polare, 1 modular, 10A, 250V Kabell rrjeti kompjuterik, Tip FTP-cat 6a; 1200MHz up 1500 MHz, 100 OHMS; AWG 23; LSOH, Flame retardant Kanaline metalike rrjete 200x50 mm Suporte per montim kanaline 200x50 (Profil per montim ne mur, montim ne dyscheme apo per varje ne tavan sipas situates, me te gjithë aksesoret, flutur metalike per prizhonier M8, Dado M8 + Rondele + Rondele e care (grower), Kanaline metalike rrjete 150x50 mm Suporte per montim kanaline 150x50 (Profil per montim ne mur, montim ne dyscheme apo per varje ne tavan sipas situates, me te gjithë aksesoret, flutur metalike per prizhonier M8, Dado M8 + Rondele + Rondele e care (grower), Kanaline rrjet 100x50 mm Suporte per montim kanaline 100x50 (Profil per montim ne mur, montim ne dyscheme apo per varje ne tavan sipas situates, me te gjithë aksesoret, flutur metalike per prizhonier M8, Dado M8 + Rondele + Rondele e care (grower) Kanaline metalike 75x75 mm Kapak Kanaline metalike 75x75 mm Aksesore per kanaline 75x75 (Xhunto, Bashkuese, Kthesa, Kryqezime, Reduktore mbylles fundore ne plan, ne ngjitje, kapak aksesoresh etj sipas rastit) Suporte per montim kanaline 75x75 (Profil per montim ne mur, montim ne dyscheme apo per varje ne tavan sipas situates, me te gjithë aksesoret, flutur metalike per prizhonier M8, Materiale te tjera plotesuese (profile, stafa,aksesor per kende variabel, element tokezues, kapak per aksesor) Tub Ø 25 mm rigid i drejte me aksesore montimi Kuti shperndarese j/m. me kapak IP 55 120mm x 80mm x 50mm Kuti shperndarese j/m. me kapak IP 55 150mm x 110mm x 70mm F.V. Tub Ø 25 mm guaino Aksesor montimi V. Ndriçues emergjence, rezistent ndaj zjarrit sipas (EN 60695-2-10) deri ne temperaturen 850°C, IP-42, IK 07,	
--	--	--	--

		Led 2,4 VA, jetegjatesia mbi 10 vjet, bat.NiCd me autonomi 1 ore, 220/230V, 50 Hz V. Ndriçuesë evakuimi (EXIT), rezistent ndaj zjarrit sipas deri ne temperaturen 850° C, IP 40, IK 07, Led 8,5 VA, 100 000 ore pune, bat.NiCd me autonomi 1 ore, 220/230V, 50 Hz Percjelles Bakri NO7V 10mm2 V/J Percjelles CU 10mm² i zhveshur Zbarre Ekuipotenciale Percjelles Bakri NO7V 6mm2 V/J Kabell 2x2x0,8mm2 F.V.Zgjerues bordi per loop F.V.Baze dhe Dedektor tymi & nxehtesie te adresuar, optik -jonik - termik komplet F.V.Sirena lajmeruese te brendshme F.V. Sirena lajmeruese te jashtme F.V.Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, kapak etj, IP 65 aktivizimi F.V Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, kapak etj,, IP 65 caktivizimi F.V. Flash light alarmi F.V.Kontakte magnetike incaso per montime ne dyer dhe dritare F.V. Modul komunikimi I lexuesit dhe butonit te dyerve me centralin F.V Kundra-Brave elektrike F.V. Lexues afersie te kartave te komandimit te dyerve F.V. Buton komandimi per hapjen e dyerve F.V. Karte afersie per hapjen e dyerve F.V, Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6 F.V. Patch panel me 24 porta RJ-45, UTP cat 6e F.V. Drejtues kabllosh F.V. Grup ventilatoresh me 2 FAN per rack F.V. Set 8 shuko per rack F.V Patch panel me 24 porta RJ-45, FTP cat 6e F.V Switch me 24 porta RJ-45, 100/1000 POE F.V. Monitor 50 " LCD, ultra HD, 4K F.V. VMS per monitorimin e sistemit F.V Program monitorimi + License e programimit te sistemit F.V. Patch corda me FTP-cat-6 me dy koka konektoriale, L=1 m F.V PDU 32A, 230V F.V. Server BMS kompletuar me bazament F.V Ushqyes per Serverin BMS kompletuar me bazament F.V. Modul Digital Input me 16 hyrje digitale kompletuar me bazament F.V. Modul Universal Input me 16 hyrje universale kompletuar me bazament F.V Modul Digital Output me 12 dalje digitale kompletuar me bazament F.V. Aksesore per komunikimin e pajisjeve F.V. Konvertues ModBus ne TCP/IP F.V. Sensor Temperature (ambjent i brendshem) F.V Sensor Temperature dhe Lageshtie (ambjent i brendshem) F.V Sensor per detektimin e rrjedhjes se ujit (ambjent i brendshem) F.V. Ushqyes per panelin F.V.Morseteri dhe aksesore brenda panelit F.V. Kabell brenda panelit F.V Kundra Brave elektrike/ Elektromagnete F.V Lexues afersie te kartave te komandimit te dyerve, me mundesi leximi me PIN ose karte F.V.. Karte afersie per hapjen e dyerve, te bardha te printueshme, material PVC F.V.Cilinder 80 Litre I pajisur me solenoid F.V.Sensor per monitorimin e presionit te cilindrit	
--	--	--	--

		F.V Aksesor per fiksimin e cilindrit F.V.Agjent Novac ose ekuivalent F.V Shkarkues Alumini 360o 1/2" F.V.Detektor tymi per ambjentin kryesor F.V Detektor termik per ambjentin kryesor F.V. Pulsant alarm zjarri me thyerje xhami, kapak etj F.V Sirena lajmeruese 24VDC ose ekuivalent F.V.Battery 12V/5Ah ose ekuivalente F.V. Zile e motorizuar 24VDC ose ekuivalente V. Ndricues Stop Gas V. Panel kontrolli me tre zona per nje ambjent te vetem I pajisur me butonin manual per clirimin e gazit nga bombula V . Shkarkues Alumini 360o 1" V Kontrolleri i lexuesit dhe butonit te dhyerve me centralin i cili ka memorie te brendshme per min. 30,000 ngjarje, mundesi per furnizim me 10- 30V DC dhe/ose PoE IEEE 802.3af/at, komunikimi TCP / IP V Central zjarri [Fire Alarm Panel, Control M Control/Intelligent Addressable], me mundesi komunikimi ne rrjet centrale nepermjet kartave essonet, i adresueshem ,230V /12V, 24 h/aut. 127 elemente per loop (komplet centrali, modul operimi, LCD panel, Karte Loop, Karte RL etj. V. Centrali I alarmit per menaxhim te hyrjes dhe menaxhimit te aksesit me mundesi komunikimi ne rrjet dhe zgjerimi te mevonshem V. Central telefonik IP, PABX 4 hyrje / 120 dalje V. Switch me 24 porta RJ-45, 100/1000 POE, me 2 porta fiber optike. Komplet me nderfaqesin e fibres te perfshire, FTP cat 6e V. Router qendror WIFI komplet me centralin e sinkrozimit per 6 acces point V. Switch I menaxhueshem 24 10/100/1000Mb/s RJ45 Ports (Auto Negocim/Auto MDI/MDIX) V. NVR 24, IP Kanale , me 24 kanale V. Kamera te brendshme, V. Kamera te jashtme V. Kamera te brendshme, per server room V. UPS 20kVA + Karte rrjeti V. Rack 800mm Wide x 1000mm Deep Enclosure V. Central GSM V. Panel Elektronik per BMS etj	
NS 18A	Punime topogjeodezike	Punime matje volume dhe piketimi te elementeve b/a si : soleta , themeli , kollona ,ndertimit depos, matjen e te gjitha ketyre objekte ne gjatesi dhe ne lartesi ,rilevimi i terrenit ku do realizohet objekti dhe sistemimet e jashtme etj.	A (0- 20 milionë lekë)

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë, dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Kontratë pune e vlefshme;
- b) Diplomë.
- c) C.V (përkatëse)

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

2.3.4 Një punësim minimalisht prej **80 (tetëdhjetë)** punonjës, të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave.
- b. Listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit që kerkohet nga legjislacioni në fuqi për **3 muajt** e fundit të deklaruar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Në përcaktimin e numrit të punonjësve specialisti i fushës ka bërë një analizë bazuar tek faktorët, si volumet dhe kategoritë e punimeve, kualifikimi i punonjësve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e

tyre në punë me kohështrirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përpiket të kufizojë edhe problematikën sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës. *Po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve.* Vendosija e kriterit për një punësim të paktën 80 punonjës duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën e punimeve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM Nr. 216, datë 13.04.2023 “ *Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport).

(Numri i punonjësve, i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore)

Në mënyrë të përmbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohet për realizimin e punimeve është min **80 punonjës**.

2.3.5 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, CV, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**
- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi profili Strukturist**
- **1 (një) Inxhinier Elektrik**
- **1 (një) Inxhinier Mjedisi**
- **1 (një) Inxhinier Mekanik**
- **1 (një) Inxhinier Hidroteknik**
- **1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshejder**
- **1 (një) Inxhinier Elektronik/IT/Telekomunikacion**
- **1 (një) Arkitekt**

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtues teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Lidhur me kërkesën që Drejtuesit Teknik të punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike. Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohej të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” germa “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKB apo gjykatë. Ndalohej ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetes si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NP1, NP2, NS4**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierëve të Ndërtimit dhe Arkitekt.**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS2**, eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Hidroteknik.**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS3** eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Mekanik.**
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS12**, eshte e nevojshme prezenca e **një Inxhinier Mjedisi.**

- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS14**, është e nevojshme prezencat e **një Inxhinieri Elektrik dhe Inxhinierit Elektronik/IT/Telekomunikacion**.
- Referuar në preventivin e Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës **NS18**, është e nevojshme prezencat e **një Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder**

2.3.6 Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe staf (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- **1 (një) person, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Materialeve/Produkteve të Ndërtimit /Inxhinier Materialesh.**

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës perkatese të DST, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë/Certifikatë, Librezë pune dhe C.V si edhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për **3 muajt** e fundit.

Shënim: Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa “c”.

Kriteri për stafin e mësipërm, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve të ndërtim, hidroteknik, etj është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar jo domosdoshmërisht të përfshirë në licencën e shoqërisë është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkrendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2.3.2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar si me siper, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

2.3.7. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kete si staf mbështetës (me kontrate pune/kontratë bashkëpunimi) si më poshtë:

- a) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".
- b) 1 (një) punonjës i pajisur me çertifikatë "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave" e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4.
- d) 3 (tre) punonjës të pajisur me çertifikatë : "Specialist për punimet në lartësi".sipas V.K.M Nr.312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", te cilat te jene te leshuara nga shoqëri të licencuara/akredituara ose nga organizma ndërkombëtare të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- e) 2 (dy) specialist të çertifikuar për "Sistemet CCTV" ose ekuivalent

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat individuale të punës (të vlefshme).
- Diplomë/Çertifikatë

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme mbështet në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Natyra e

kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit e kërkuar, nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangë apo parandalojë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

-“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” rekomandohet të jete ne kantier per trajnimin e punonjesve te kantierit per minimizimin e aksidenteve ne pune.

-“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune .

-“Specialist Ekspert Zjarrfikës” ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4. " Rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

-Punonjësit E pajisur me certifikaten e Trajnimit për “Punime në lartësi” është sipas V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier" në projekt-preventiv ka punime skelerie ne lartësi, te cilën e ben te nevojshme kërkesa për punonjës të certifikuar dhe trajnuar per punime na lartësi.

-“Specialist të certifikuar në nivel profesional për network ose ekuivalent dhe për “Sistemet CCTV” ose ekuivalent” duke u bazuar sipas zërave të preventivit dhe projektit të zbatimit .

Specialistët e kërkuar janë të nevojshëm për instalimin, integrimin, konfigurimin dhe vendosjen në punë të sistemeve pjesë të këtij objekti prokurimi. Dokumentacioni i kërkuar për punonjësit është i nevojshëm për të provuar që është i certifikuar në një nga fushat e kërkuara dhe është në marrëdhënie pune pranë operatorit/ve ekonomikë ofertues.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik per kryerjen e punimeve, te vertetuar me kontratë punë te vlefshme, një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë),lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republika e Shqipërisë”. Dëshmi te Sigurimit Teknik e leshuar nga ISHTI ose nga nje trup çertefikuese e akredituar nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për 3 muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave, si më poshtë:

STAF TEKNIK	NUMRI
Teknik Ndërtimi	1
Teknik IT/Elektronik	1
Hidraulik	2
Elektricitist	4

Instalues dhe riparues te sistemeve ngrohje-ftohje	2
Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe te ngjashem	2
Hekurkthyes	3
Karpentier	4
Betonues	4
Punonjes i izolimeve (Hidroizolues)	2
Murator	3
Suvatues	4
Pllakashtrues	4
Specialist gipsi	2
Punonjes per dyer dritare	2
Bojaxhi	3
Eskavatorist	2
Shofer	3
Automakinista	2

2.3.8/1 Për punonjesit eskavatorist/ automakinist/shofer, ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) kontratë individuale të punës;
- b) leje drejtimi, certifikate e aftesimit profesional (CAP) per shoferet dhe dëshmi aftesimi profesional (DAP) per manovratorët-automakinistët/eskavatoristët, që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

(Në rastin kur punonjësit Manovrator/shofere janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”I ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen, si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet

teknike. Zbatimi i punimeve që përfshin projekti duhet të kryhet nga fuqi punëtore e kualifikuar për secilën tipologji punimesh. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/ certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”. Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga institucione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të regjistruara në “rregjistrat profesionale” të AKAFP-se. Përcaktimi i numrit të punonjesve dhe profesionet është bazuar mbi zërat dhe volumet e punës si dhe afateve për perfundimin e punimeve, në mbështetje të janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”. Bazuar në këto elementet e strukturës së kostos (material, puntori, makineri, transport). Numri i punonjësve, dhe profesionet që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nenligjore. Personeli i mësipërm kërket në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

2.3.9 Deklaratë e ofruesit për modelin, kompaninë prodhuese, për mallrat e paisjet që do të vendosen në objekt sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i pajisjes/materialeve	Modeli	Kompania prodhuese, Web, E-mail, Nr. kontakti
1	Ashensor i kompletuar me të gjitha aksesoret për mallra dhe pasagjer sipas standartit EN 81-1 Kapaciteti: 6 persona, Shpejtesia: 1m/s me 2 Ndalesa, 2 Porta		
2	F. Pompa e furnizimit me uje Karakteristikat Teknike: -Prurja: 9.8m ³ /h; -Prevalenca: 45 mkH ₂ O; -Tensioni i dhenë : 3F - 400V / 50 Hz; -Bashke me rakorderite për lidhjen		
3	F. P-MKZ Pompe furnizimi për sistemin e mbrojtjes nga zjarri e kompozuar sipas referuar normes EN 12845. - Pompa Motor Elektrik Prurja: V=45 m ³ /h Presioni: H=65mkH ₂ O Fuqia: 55 kW Lidhja elektrike, 3~400 V, 50 Hz		
4	F. KOMPRESOR I SISTEMIT "VRV" VERSION POMPE NXEHTESIE - RXYQ-U (Ngrohje jo e vazhdueshme VRV IV), - Kapaciteti termik maksimal në Ftohje: Q = 45 kW - Kapaciteti termik maksimal në Ngrohje: Q = 50 kW - SCOP = 4.0 - SEER=6.0		
5	Pajisje e Kondicionimi - Njësi e hollë me tavan të fshehur , kapaciteti në ftohje / ngrohje 2.2 / 2.5 kW, prurja e ajrit mesatare = 480 m ³ /h, fuqia elektrike 26W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.7mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me të gjithë elementet		
6	Pajisje e Kondicionimi Round Flow: Kasetë me rrjedhje të rrumbullakët, kapaciteti në ftohje / ngrohje		

	3.6 / 4.0kW, prurja e ajrit mesatare =768m³/h, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.7mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithë elemente e nevojshem		
7	Pajisje e brendshme VRV Tipi Kasete me kater drejtime, Round Flow: Kasetë me rrjedhje të rrumbullakët, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 9.0/ 10.0 kW,, prurja e ajrit mesatare =1380m³/h, fuqia elektrike 36W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 15.9 mm / Ø9.5 mm, Ventilator DC Inverter		
8	Pajisje e brendshme VRV- Kasetë plotësisht e sheshtë, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 1.7/ 1.9 kW, prurja e ajrit mesatare =480 m³/h, fuqia elektrike 40 W, lidhjet Gaz / Leng - Ø 9.5 mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithë elemente		
9	Pajisje e brendshme VRV - Kasetë plotësisht e sheshtë, , kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.2/2.5 kW, prurja e ajrit mesatare =480 m³/h, lidhjet Gaz / Leng - Ø 12.75 mm / Ø6.4 mm, Ventilator DC Inverter I kompletuar me te gjithë elemente e nevojshem per montim		
10	Central zjarri [Fire Alarm Panel, Control M Control/Intelligent Addressable], me mundesi komunikimi ne rrjet centralesh nepermjet kartave essenet, i adresueshem ,230V /12V, 24 h/aut. 127 elemente per loop (komplet centrali, modul operimi, LCD panel, Karte Loop, Karte RL etj.		
11	Central telefonik IP, PABX 4 hyrje / 120 dalje		
12	Switch I menaxhueshem 24 10/100/1000Mb/s RJ45 Ports (Auto Negocim/Auto MDI/MDIX)		
13	NVR 24, IP Kanale , me 24 kanale		
14	Kamera te brendshme, per server room		
15	UPS 20kVA + Karte rrjeti		
16	Gjenerator diesel 3fazor 100KVA me panel komandimi komplet		

2.3.9/a Për pajisjet/materialet e tabelës së dhënë në pikën 2.3.9, Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, me të cilin prodhuesi ose distributori i autorizuar, autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/materialet. Në rast paraqitje autorizim distributori i autorizuar, duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet kryesore të kërkuara.

2.3.9/b Të paraqiten katalogët nga prodhuesi/prodhuesit apo distributorit te autorizuar nga prodhuesi, për të gjitha paisjet/materialet sipas pikës 2.3.9. Në katalogë, duhet të markohet me ngjyrë të qartë pajisja/materiali që ofrohet dhe të pasqyrohen specifikimet teknike të kërkuara për këto pajisje/materiale.

2.3.9/c OE te paraqese një deklaratë, ku merr përsipër të garantojë instalimin si dhe servisin e pajisjeve gjatë periudhës së garancisë (2 vite), për defektet që vijnë nga prodhimi i tyre.

Fleta ose fletët e katalogut që pasqyrojnë specifikimet teknike të kërkuara të pajisjes/materialeve, duhet të paraqiten në gjuhën shqipe, të përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 8, si dhe në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në preventivin e punimeve ka një numër të madh zërash që janë furnizim vendosje pajisje dhe nisur nga pesha specifike si në sasi dhe në vlerë që këto zëra zënë në preventive. AK e ka parë të domosdoshme kërkimin e autorizimit të prodhuesit për të garantuar cilësinë e pajisjeve për nga vetë rendesia që ka ky objekt. Kërkesa e këtij dokumenti që ne kete faze krijon një lehtësi për Autoritetin Kontraktor pasi ne kete mënyrë siguron cilësinë, specifikimet teknike të ketyre pajisjeve e cila është lehtësisht e kontrollueshme gjatë fazes së zbatimit në reference me dokumentat e paraqitura që gjatë kualifikimit. Nepermjet dorezimit të këtij dokumentacioni që ne fazën e vlerësimit asnjë OE ekonomik nuk i shmanget dot detyrimit që gjatë zbatimit të furnizojë të njëjtin mall të certifikuar nga KVO.

Kjo kërkesë është kërkuar që t’i sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, është gjykuar të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit. Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme, vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që të përdoren në këtë objekt dhe konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, kataloge, ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotësimi i kërkesës me sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **18 (tetëmbëdhjetë)** muaj kalendarikë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Nenin 39, pika 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.11 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH/DIN/EN/UNI **ISO 9001-2015** e përditësuar, e vlefshme/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- b) Certifikatën për Sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH/DIN/EN/UNI **ISO 14001-2015** e përditësuar, e vlefshme /ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- c) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001:2018** e përditësuar, (SSH/DIN/EN/UNI **ISO 45001 – 2023**) e vlefshme/ ose ekuivalent (Mbi Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë të punëtorëve në punë ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- d) Certifikatën SSH/DIN/EN/UNI **ISO 50001-2018**, e përditësuar, e vlefshme/ ose ekuivalent (Sistemi i Menaxhimit të Energjisë e vlefshme ose ekuivalent). Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik do të paraqesë ISO-t në baze të zerave të punimeve që ka marrë persiper të realizojë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare **SSH/DIN/EN/UNI/ISO** mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.11 gërma “a”- “d” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm

nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 / ekuivalente është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 / ekuivalente ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018/45001-2023 / ekuivalente është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 ose ISO 45001-2023 ose me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018/ ekuivalente është standart ndërkombëtar, i cili specifikon kërkesat e përgjithshme për krijimin e një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë në një organizatë dhe fokusohet në identifikimin e mundësive për përmirësimin e performancës së energjisë. ISO 50001 përcakton synimet dhe objektivat specifike për kursimin e energjisë, të cilat arrihen përmes programeve për menaxhimin e energjisë dhe monitorimin sistematik të variablave të energjisë.

Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”.

Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat e parashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 2.3.11 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

2.3.12 Operatori Ekonomik duhet te disponoje:

Licence të leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) Kodi III.2.B (Për grumbullim dhe transport të mbetjeve inerte dhe të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, në përputhje me parashikimet e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, i ndryshuar, e shoqëruar me Aktin e Miratimit.

Çertifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se: *“leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”*.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”*.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538, datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (qkl) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”: *“Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”*.

2.3.13 Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi/cope	Statusi
1	Kamion kapaciteti mbajtës min 20 ton	copë	2	Në pronësi ose me qera
2	Kamion kapaciteti mbajtës 10-20 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Kamionçine kapaciteti mbajtës min 1.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Eskavator me goma	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Autobetoniere	copë	3	Në pronësi ose me qera
6	Autopompe betoni / Pompe betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
7	Mini Fadrome/ Bobcat	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Kamion me vinc	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Elektrosaldatrice/Motosaldatrice/Saldatrice	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator betoni	copë	3	Në pronësi ose me qera
12	Pompe uji	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Pajisje niveluese shtresash	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Gjenerator / Motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qera

16	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Depozite uji min 5000 litra	copë	1	Në pronësi ose me qera
18	Vinc me kosh	copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Makineri për kthim hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
20	Makineri për prerje hekur ndertimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
21	Fabrike Betoni, pajisur me leje mjedisore nga QKL	copë	1	Në pronësi / me qera ose kontratë furnizimi
22	Skela metalike	m2	500	Në pronësi ose me qera

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- b) Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet: kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, certifikatë për transport mallrash (e vlefshme).
- c) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit Nr. 8 të DST.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me Nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim"

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së

punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

Në të gjitha rastet ku është përmendur fjala markë, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe “ekuivalentin” e tij/tyre.

Në të gjitha rastet kur AK në specifikimet teknike i është referuar vetëm standarteve europiane, Autoriteti Kontraktor do të pranojë edhe paraqitjen e standarteve SSH/DIN/EN/UNI/ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Janë sipas të dhënave dhe shënimeve teknike në projektet e zbatimit, relacionet, specifikimet etj. bashkëlidhur DST-ve, të dërguara pranë organit qendror blerës nga Autoriteti Kontraktor perfitues(QKUM) dhe të hartuara nga projektuesi.

NJESIA E PROKURIMIT